



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të “Tregtia” SHPK dhe Bedri (Smajl) Prishtina.
- II.
  1. Prona e paluajtshme komunale që do të këmbëhet, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës nr. 554-0, me sip. 1110 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00554-0, pjesa e parcelës nr.533-0, me sip.1095 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00533-0, pjesa e parcelës nr.457, me sip.1138m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00457-0, pjesa e parcelës nr.547, me sip.251m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr.P-71914050-00547-0, pjesa e parcelës nr.555-1, me sip.596m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00555-1, pjesa e parcelës nr.548-0, me sip.4205m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00548-0, pjesa e parcelës nr.549-0, me sip.1152m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00549-0, pjesa e parcelës nr.553-0, me sip.130 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00553-0, parcela nr.612-3, me sip.1037m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00612-3 dhe pjesa e parcelës 457-0 sip. 1138, Certifikata e pronësisë P-71914050-00457-0, Zona Kadastrale, Matiçan, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues urban “Mati 1” në Prishtinë 2017-2025, i miratuar me Vendimin nr. 01-020/01-0142459/17, dt.14.06.2017 dhe Planit rregullues 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010.
  2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, janë parcela nr.10320-0, me sip 4269 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914059-10320-0, në pronësi të Bedri (Ismajl) Prishtinës, dhe pjesa e parcelës nr.1081-0, me sip. 602 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914059-01081-0, Zona kadastrale Prishtinë, parcela nr. 858-0, sip. 4858 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914066-00858-0, Zona kadastrale, Sofali, në pronësi të “Tregtia” SHPK, me destinim infrastrukturë rrugore të planifikuar dhe gjelbrim.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues urban “Mati 1” në Prishtinë, 2017-2025, i miratuar me Vendimin nr. 01-020/01-0142459/17, dt.14.06.2017 dhe Planit rregullues 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### Arsyetim

Me Kërkesës nr. 13-464/01-106016/21/1, dt. 10.06.2021, të dërguar nga “Tregtia” SHPK dhe Bedri (Smajl) Prishtina, ka kërkuar që prona private e planifikuar për interes publik të kompensohet, gjegjësisht të shpronësohet sipas vlerës së tregut, për parcelat nr.10320-0, me sip 4269 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914059 -10320-0, pjesa e parcelës nr.1081-0, me sip. 602 m<sup>2</sup> Certifikata e pronësisë P-71914059-01081-0, Zona kadastrale, Prishtinë, dhe parcela nr. 858-0, sip. 4858 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914066-00858-0, Zona kadastrale Sofali, në pronësi të “Tregtia” SHPK, dhe Bedri (Smajl) Prishtina.

Propozimi për inicimin e këmbimit të pronës komunale me pronën private të cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues urban “Mati 1” në Prishtinë, 2017-2025, i miratuar me Vendimin nr. 01-020/01-0142459/17, dt.14.06.2017 dhe Planit rregullues, 01.nr.35-642, dt. 01.04.2010, ku prona private është planifikuar për interes publik ashtu siç është cekur më lart, ndërsa prona komunale, gjegjësisht pjesa e parcelës nr. 554-0, me sip. 1110 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00554-0, pjesa e parcelës nr.533-0, me sip. 1095 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00533-0, pjesa e parcelës nr. 457, me sip. 1138m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00457-0, pjesa e parcelës nr.547, me sip.251m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr.P-71914050-00547-0, pjesa e parcelës nr.555-1, me sip.596m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00555-1, pjesa e parcelës nr.548-0, me sip.4205m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00548-0, pjesa e parcelës nr.549-0, me sip.1152m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00549-0, pjesa e parcelës nr.553-0, me sip.130 m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00553-0, parcela nr.612-3, me sip.1037m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë P-71914050-00612-3 dhe pjesa e parces 457-0 sip. 1138, Certifikata e pronësisë P-71914050-00457-0, Zona kadastrale Matiçan, është planifikuar ndërtim. Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/03-112352/21, më 16.06.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

